

VENDIM
Nr. 652, datë 7.8.2013

**PËR NJË SHITESË FONDI NË BUXHETIN E VITIT 2013, MIRATUAR PËR MINISTRINË E
PUNËVE PUBLIKE DHE TRANSPORTIT, NË PROGRAMIN “TRANSPORTI RRUGOR”**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 5 e 45 të ligjit nr. 9936, datë 26.6.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, dhe të nenit 13 të ligjit nr. 119/2012 “Për buxhetin e vitit 2013”, me propozimin e Ministrit të Punëve Publike dhe Transportit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Ministrisë së Punëve Publike dhe Transportit, në buxhetin e miratuar për vitin 2013, në programin “Transporti rrugor”, t’i shtohet fondi prej 200 000 000 (dyqind milionë) lekësh, për financimin e punimeve të kryera dhe të pafinancuara të objektit “Sistemim-asfaltim, rruga Kukës-Krumë, loti 2”.

2. Ky fond të përballohet nga fondi i kontingjencës i Këshillit të Ministrave.

3. Ngarkohen Ministria e Financave dhe Ministria e Punëve Publike dhe Transportit për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha